



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PUKË  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1118/2 prot:

Pukë, më 04.06.2024

VENDIM

Nr. 24 datë 29.05.2024

PER

**PËR PROPOZIM PËR SHPALLJE "DËSHMOR I ATDHEUT"**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 „Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 109/2018 “Për statusin e Dëshmorit të Atdheut”, neni 5, pika i), neni 8, pika 1), neni 10, pika 6), neni 11, si dhe VKM nr. 151, datë 25.04.2002 “ Për statusin Dëshmor i Atdheut”, i ndryshuar; si dhe pas shqyrtimit në komisionin këshillimor të vlerësimit të figurave:

VENDOSI

1. T' i propozojë Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut”, shpalljen “Dëshmor i Atdheut”, të të ndjerit Anton Lazër Gjergji, me motivacion: **“Për veprimtarinë e tij në luftën kundër bandave të armatosura dhe krimit ndaj jetës së individit”**.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë 10 ditë pas shpalljes.
4. **Shpallur me date 04.06.2024**

Miratuar me 9 vota pro, Vota Pro 9, Vota Kunder 0 , Vota Abstenim 0 .

SEKRETARE

Hazbi TERBUNI

KRYETARI I KESHILLIT

Eduard GJOKA



26.06.24

sek. (cshw) /  
2. Hqz / T. R. /



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

11/8/4  
24.06.2024



Nr. 419/1prot.

Shkodër, më 20.06.2024

**LËNDA:** Mbi vendimin Nr.24, datë 29.05.2024 të Këshillit të Bashkiak Pukë.

**KËSHILLIT BASHKIAK PUKE**

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin Nr.107 dt.27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 8 shkronja a, Urdhërit të Ministrit të Brendshëm Nr.175 dt.9.07.2020 “Për miratimin e rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut” si dhe aneksi 1 “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut”, Urdhërit të Kryeministrit Nr.50, datë 12.04.2017 “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut”, Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 54/n, Ligjit Nr.109/2018 dat.20.12.2018 “Për statusin e dëshmorit të atdheut”, VKM Nr.151 datë.25.04.2002 “Për statusin dëshmorë i atdheut” i ndryshuar, shqyrtoi VKB Pukë Nr.24 datë 29.05.2024: “Mbi propozimin për shpallje dëshmorë i atdheut Z. Anton Lazër Gjergji (pas vdekjes)”.

Për shqyrtim të mëtejshëm, pas trajtimit të VKB dhe materialit bashkëlidhur, mungon dokumentacioni argumentues, sipas kërkesave të nenit 11 pika 1-5 të Ligjit Nr.109/2018 dat.20.12.2018 “Për statusin e dëshmorit të atdheut” .

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin, mbetemi në pritje të dokumentacionit.

**P R E F E K T I**

**Majlinda ANGONI**

